

RIFINITURA



FINO 07

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
E bardhë	25 KG	3.7kg/m ² për 3mm trashësi

PËRSHKRIM

Produkt me bazë çimento për mure të brendshme dhe tavane me strukturë finale të imët. I përshtatshëm për të gjitha tipet e bazamenteve me bazë çimento-gëlqere të cilat nuk kanë karakteristike fleksibilitetin e lartë.

FUSHA E APLIKIMIT

Mbi të gjitha tipet e bazamenteve me bazë çimento-gëlqere. I përshtatshëm për bazamente me mbushje tradicionale dhe me llaçra të parapërgatitur. Shtresë me dy duar për rrafshimin e tavaneve dhe mureve të brëndshme. Karakterizohet nga një punueshmëri shumë e mirë dhe kohë tharje optimale.

PËRGATITJA E BAZAMENTIT

Bazamenti duhet të jetë i pastër pa pluhura, vajra apo mbetje të cilat bëhen pengesë në lidhjen midis shtresave. Pastrimi i bazamentit bëhet në mënyrë mekanike ose manuale. Bazamentet me aftësi të lartë thithje duhet të lagen paraprakisht përpara aplikimit të produktit.





APLIKIMI

Përzjeni me një përzjerës elektrik 6-6.5 litra ujë me një thes 25 kg Fino 07 në një enë të pastër, deri sa të arrihet një masë homogjene dhe pa kokrriza. Lëreni produktin në qetësi për 10 minuta dhe më pas përzjejeni përsëri përpara përdorimit. Aplikoni produktin me një mallë dhe bëni nivelimin e saj, në një trashësi prej 3 mm. Pas 10-15 min fërkojeni sipërfaqjen me përdaf derisa të nxirrni kokrrizën. Temperatura e aplikimit të produktit duhet të jetë sa më optimale.



TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur	Rezistenca në përkulje: 0.6 N/mm ²
Paketimi: Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg	pH i përzierjes: 13
Ngjyra: E bardhë	Reaksioni ndaj zjarrit: A1 Class
Kokrrizimi: 1, 1.5, 2, 3 mm	Absorbimi i ujit: W1
Koha e magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit	Grafiato 1 mm, strukturë e plotë: 12 m ² /thes
Trashësia e aplikimit: Max sa granula më e madhe	Grafiato 1.5 mm, strukturë e plotë: 8-9 m ² /thes
Ujë për përzierjen: 6 litra ujë për 25 kg	Grafiato 2 mm, strukturë e plotë: 7.5-8 m ² /thes
Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C	Grafiato 3 mm, strukturë e plotë: 6.5-7 m ² /thes
Rezistenca në ngjeshje: 5.1 N/mm ²	Konduktiviteti termik: 0.52 W/mK



Kujdes! NUK rekomandohet aplikimi i finos ne suporte me fleksibilitet te larte si sistemi kapot apo produkte te tjera fleksibel , ne siperfaqe te paqendrueshme ose ne disnivele te medha . ! Si temperaturat e ulta dhe temperaturat e larta mund te ndryshojne karakteristikat e punimit te produktit (ngadalsim ose pershpejtim ne tharje te produktit). Mos e perdorni ne:

- Suporte druri,metali, PVC apo siperfaqe te tjera jo me baze çimento.
- Në ambiente ku ka lagështirë të vazhdueshme,
- Suporte që karakterizohen nga vibrime të paqëndrueshme.
- Në temperatura të larta, të ulëta, me erë të fortë.